

KËRKESË
Nr. 1728, datë 7.6.2019

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT
“ALBERT SHEHU”

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

- “ALBERT SHEHU”

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Elvisjon Salku

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT-TR-2019-000505-5

Datë 30.5.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit nr. ISHMPUT-TR-2019-000505-2, datë 30.5.2019, inspektim që është zhvilluar në subjektin Albert Shehu, me NIPT L91508029C, përfaqësues i autorizuar i subjektit Albert Shehu, prej datës 30.5.2019, ora 08:30 deri më datën 30.5.2019, ora 12:30.

Grupi i inspektimit, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit më datë 30.5.2019 dhe e njoftoi më datën 30.5.2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit, rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 9774, neni 32, pika 1/e,

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. 9774, datë 7.12.2007, nenit/neneve 32, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

- Gjobë 5 000 Lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

- Pezullim i makinerisë zhurmëprodhuese (Elektromotorri Frigoriferik) deri në marrjen e masave për minimizimin dhe eliminimin e zhurmave të gjeneruara nga pajisja zhurmëprodhuese.

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Florian Kryemadhi ID: 0301020021

Andi Dore ID: 0301020030

*Kundër Vendimit Përfundimtar, subjekti **Albert Shehu** ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror”, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.*